

SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL SKEDA E VENDIT NË KOSOVË*

Institucioni Anëtar i Forumit të ETF:
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Dhjetor 2020



Quality Assurance Forum

FORUMI I FONDACIONIT EVROPIAN TË TRAJNIMIT (ETF) PËR
SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL



* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

Permajtja e këtij raporti është kendveshtrimi i ETF dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmerisht kendveshtrimin e institucioneve të Bashkimit Evropian.

© Fondacioni Evropian i Trainimit, 2021

Autorizohet ri-prodhimi, atëherë kur citohet burimi.

PËRMBAJTJE

1.	PREZANTIM	4
1.1	Konteksti kombëtar	4
1.2	Statistikat	4
1.3	Sistemi i AAP-së	5
2.	SIGURIMI I CILËSISË NË AAP	8
2.1	Pamje e përgjithshme	8
2.2	Informatat e përgjithshme mbi sigurimin e cilësisë në nivel sistemi të AAP-së	8
2.3	Sigurimi i cilësisë në lidhje me fushat kyçe të AAP-së	8
3.	PËRPARËSITË, ZHVILLIMET DHE NEVOJAT	11
3.1	Nevojat dhe sfidat	11
4.	SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA	12

1. PREZANTIM

1.1 Konteksti kombëtar

Konteksti ekonomik dhe sfidat

Një treg shumë i vogël i brendshëm, integrimi i kufizuar në tregjet ndërkombëtare dhe një mjedis biznesi nënoptimal, përfshirë çështjet që lidhen me infrastrukturën (p.sh. energjinë), kornizën rregullatore dhe të mbështetjes së biznesit dhe informalitetin e përhapur, kanë çuar në nivele të ulëta të krijimit të vendeve formale të punës dhe, si rrjedhim, ka ngadalsuar kërkesën e punës. Këto, nga ana tjetër, kanë shtuar probleme në tregun e punës.

Zhvillimet demografike

Zhvillimet demografike tregojnë një rënie të lartë në popullatën e re për shkak të rënies së vazhdueshme të lindjeve edhe për shkak të emigrimit të të rinjve dhe familjeve të reja.

Konteksti dhe sfidat e tregut të punës

Treguesit e tregut të punës për Kosovën qëndrojnë shumë mbrapa nga vendet tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor¹ dhe Bashkimit Evropian (BE). Numri i lartë i punëkërkuësve të rinj në tregun e punës çdo vit dhe mungesa e vendeve të lira të punës, nënkuptojnë norma të larta mungese aktiviteti dhe papunësie. Kosova ka aktivitetin më të ulët të femrave dhe papunësinë më të lartë të rinjtë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që së bashku rezultojnë në shfrytëzim shumë të ulët të aftësive të këtyre grupeve. Të diplomuarit në universitete kanë mundësi më të mira në tregun e punës, megjithëse shumë prej tyre përfundojnë në punë që kërkojnë aftësi më të ulëta. Kjo sjell përkeqësim të mëtejshëm të shanseve për tregun e punës për personat me kualifikime të mesme ose të ulëta dhe përforcon tendencën e të rinjve që të kërkojnë të regjistrohen në arsimin e lartë. Pothuajse një ndër katër persona të punësuar në Kosovë punojnë në kushte punësimi të pasigurta, gjë që rezultojnë në përdorim joefikas të kapitalit njerëzor. Për më shume, përqindja e lartë e atyre që janë të pa punë, të pa arsimuar dhe trajnuar, përbën një rrezik për zhvillimin e drejtë të kapitalit njerëzor.

1.2 Statistikat

TABELA 1. POPULLSIA

	Madhësia e popullsisë	Madhësia relative e popullsisë së re (15–24, %)
2011	1 780 021	19,3
2014	1 816 891	19,2
2017	1 847 632	19,0

Burimi: Agjencia Kosovare e Statistikave.

TABELA 2. PUNËSIMI

	Norma e punësimit (15+, %)	Norma e punësimit të rinjtë (15–24, %)
2012	25,5	19,1
2014	26,9	8,5 (për vitin 2015)
2017	28,8	10,0 (për vitin 2018)

Burimi: Agjencia Kosovare e Statistikave.

TABELA 3. NIVELI ARSIMOR I POPULLATËS AKTIVE (15+, %)

	i ulët	i mesëm	i lartë
2015	19,2	58,0	22,9
2018	15,9	59,2	24,9

Shënim: i ulët: Klasifikimi i Standardit Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA) 0–2; i mesëm: KSNA 3–4; i lartë: KSNA 5–8.

Burimi: Agjencia Kosovare e Statistikave.

TABELA 4. PJESEMARRJA NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL (AAP) (NXËNËSIT NË PROGRAMET PROFESIONALE SI PËRQINDJE E TOTALIT TË NXËNËSVE TË CIKLIT TË MESËM)

	AFP, cikli i mesëm (KSNA 3)
2016	52,6
2018	52,9
2019	52,4

Burimi: Instituti i Statistikave të UNESCO-s.

1.3 Sistemi i AAP-së

Drejtimi dhe menaxhimi

Spektori i AAP-së menaxhohet nga \ Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rriturit (AAPARr), Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA). ministritë dhe institucionet tjera gjegjëse ndërlidhur me funksionin e tyre. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe legjislacionin e përgjithshëm arsimor, duke përfshirë edhe AAP-në. MASH mbështetet nga departamentet dhe divizionet përkatëse ndërlidhur me zhvillimin e funksioneve të AAP. Po ashtu rol të veçantë në sistemin e AAP ka edhe Këshilli për AAP dhe të rritur (KAAPARr), i cili është një organ trepalësh që ofron këshilla për akterët qeveritarë të AAP dhe arsimit për të rritur në Kosovë dhe miraton standardet e profesionit për verifikim dhe aprovim. Megjithatë këshilli u themelua në vitin 2014, për një periudhë të gjatë ka pasur vështirsi në funksionimin e plote, ndërsa tani janë ndërmarrë hapa që ky këshill të bëhet funksional.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rriturit (AAPARr) është përgjegjëse për administrimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional dhe institucioneve të AAP-së për të rriturit, në veçanti për financat, burimet njerëzore dhe ndërtimin e ndërtesave dhe infrastrukturës për të gjitha institucionet publike të AAP-së. Aktualisht, AAPARr menaxhon gjashtë institucione të tilla, ndërsa pjesa tjetër operon nën autoritetin e drejtorive arsimore të komunave përkatëse. Gjithashtu, përgjegjësi tjera të AAPARr janë edhe iniciimi i zhvillimit të standardeve të profesionit, zhvillimit të kurrikulave bërthame, zhvillimin e materialeve mësimore, zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës, etj.

DKA janë përgjegjëse për funksionimin e institucioneve publike arsimore, duke përfshirë edhe shkollat profesionale. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë: ndërtimin e ambienteve arsimore, regjistrimin e nxënësve, punësimin e stafit pedagogjik dhe drejtues, trajnimin, mbikëqyrjen etj. Drejtorët e DKA emërohen nga kryetarët e komunave përkatëse.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për hartimin e politikave të punësimin dhe të aftësimin profesional, ndërsa Agjencia e Punësimin të Republikës së Kosovës (APRK) organizon dhe koordinon dhe implementon politikat e punësimin dhe të aftësimin profesional nëpërmjet 7 qendrave regjionale të aftësimin profesional.

Financimi

Burimi kryesor i financimit është buxheti publik. Një grant caktohet për komunat bazuar në një formulë specifike dhe komunat ua caktojnë këto fonde shkollave. Pagat e mësimdhënësve paguhen përmes një sistemi pagesash të menaxhuar nga Ministria e Financave, shpenzimet kapitale menaxhohen direkt nga MASH ose komunat dhe buxheti për mallrat dhe shpenzimet caktohet direkt për shkollat sipas numrit të nxënësve.

Shkollave të AAP-së u lejohet gjithashtu të gjenerojnë të ardhura përmes aktivitetit ekonomik, siç janë aktivitetet prodhuese dhe shërbimet, dhe ato mund t'i përdorin të ardhurat për të plotësuar nevojat e tyre, duke përfshirë pagesat për stafin për punë shtesë.

Në tre vitet e fundit, pagat e stafit përbënin më shumë se 90% të totalit të granteve, duke u lënë komunave dhe shkollave pak hapësirë për të manovruar dhe investuar në aktivitete zhvillimore.

Kornizat rregullatore

Korniza ligjore për AAP dhe arsimin dhe aftësimin e të rriturve përbëhet nga ligjet, udhëzimet administrative dhe strategjitë kombëtare.

Ligjet

- Ligji Nr. 04/L-032 – 2011 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Ligji Nr. 04/L-138 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional – Ligji për AAP rregullon strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësimin profesional
- Ligji Nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës – Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës rregullon procesin për arsimin e të rriturve si pjesë përbërëse të sistemit të arsimit në Kosovë
- Ligji Nr. 03/L-060 – 2011 për Kualifikimet Kombëtare – Ligji mbi kualifikimet kombëtare rregullon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe dhënien e kualifikimeve. Objektivat e ligjit janë të përmirësojë njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin formal dhe joformal dhe të sigurojë se kualifikimet përmbushin nevojat e tregut të punës,

ekonomisë dhe shoqërisë si dhe të rregullojë kualifikimet, vlerësimin dhe certifikimin, në bazë të cilësisë dhe standardeve, etj.

- Ligji Nr. 2004/37 – 2004 për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë
- Ligji Nr. 03/L-018 – 2008 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore
- Ligji Nr. 03/L-019 – 2008 për Aftësitë Profesionale, Rehabilitimin dhe Punësimin e personave me aftësi të kufizuara
- Ligji Nr. 03/L-068 – 2008 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës

Strategjitë kombëtare

Në terma strategjike, Plani Strategjik Arsimor i Kosovës 2017–2021 shërben si dokument bazë për zhvillimin e sektorit arsimor në vend.

Objektivi specifik strategjik i lidhur me AAP-në është “Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe jashtë tij, dhe krijimi i një sistemi të hapur për arsimin e të rriturve”. Fokusi strategjik vendoset te përmirësimi i rëndësisë së programeve të shkollës sipas nevojave të tregut, te zhvillimi i një kurrikule bazë specifike për AAP-në të përafuar me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës dhe që ofron sistematikisht përvojë pune dhe praktikë profesionale të cilësisë së lartë. Plani përcakton nëntë rezultate që lidhen me objektivin strategjik specifik për AAP-në dhe identifikon një numër masash (aktivitetesh) për secilin rezultat për të monitoruar progresin drejt arritjes së tij.

Mangësitë buxhetore dhe problemet organizative janë pengesë për implementimin e strategjisë.

Lidhur me legjislacionin sekondar janë të zhvilluar një numër i konsiderueshëm i udhëzimeve administrative varësisht nga fushëveprimtaria me qëllim të zbatimit të ligjeve në fuqi. Për më shumë lidhur me sistemin e kualifikimeve dhe zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) që nga viti 2014, u miratua legjislacioni sekondar që përcakton kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardeve të profesionit, kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe për akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime, në Kosovë, si dhe kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e AAP-së, duke përfshirë proceset e brendshme dhe udhëzimi administrativ për njohjen e mësimin paraprak. Ndërsa në vitin 2019 u miratua edhe Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimin paraprak në Kosovë.

Llojet kryesore të institucioneve ofruese

Aktualisht nga institucionet publike dhe private ofrohet si arsimit formal ashtu edhe ai i të rriturve. Pas përfundimit të arsimit formal ose të arsimit për të rriturit, nxënësit/kandidatët mund të hyjnë në tregun e punës, arsimin post-sekondar ose arsimin universitar. Shumica (rreth 60%) e nxënësve të shkollës së mesme janë të regjistruar në shkollat formale të AAP-së. Gjithsej janë 76 shkolla publike të AAP-së, 17 fusha profesionale dhe 140 profile që ofrohen në këto shkolla.

Janë mbi 60 ofrues publikë dhe privatë të AAP-së të cilat janë akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe mbi 88 kualifikime të validuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Ofrimi formal i AAP-së përfshin:

- arsimit mesëm i lartë profesional (klasat e arsimit profesional 10–12);
- arsimit dhe aftësimin profesional post-sekondar.

Ofrimi joformal i AAP-së përfshin:

- trajnime profesionale (të lidhura me punësimin ose punën), të ofruar në qendrat publike dhe private të AAP;
- kurset kompensuese arsimore të të rriturve për ata që nuk e kanë përfunduar arsimin fillor ose të mesëm, bazuar në programet arsimore formale që ofrohen kryesisht nga shkollat publike;
- një shumëllojshmëri e llojeve të tjera të AAP për të rriturit në fusha të tilla si gjuhët e huaja, TIK, punimet me dorë, arti, muzika, kultura etj. të ofruara nga ofruesit privatë, OJQ-të etj.

2. SIGURIMI I CILËSISË NË AAP

2.1 Pamje e përgjithshme

Një sistem gjithëpërfshirës i sigurimit të cilësisë për AAP-në që mbulon fushat e përgjithshme të politikës duke përfshirë administrimin, ciklin e kualifikimeve, zhvillimin e vazhdueshëm profesional, evidencat dhe ofrimin e AAP-së mbetet i shkëlqyer. Masat e sigurimit të cilësisë për të mbështetur këto fusha ekzistojnë, por ato janë ose në nivel projektimi, ose të implementuara vetëm pjesërisht, ose thjesht të ofruara nga ligjet dhe legjislacioni sekondar.

Cikli i kualifikimeve duket se është fusha e politikës që mbulohet më mirë nga masat e sigurimit të cilësisë. Megjithatë, bashkërenditja e këtyre fushave të politikës kërkojnë që të gjitha ato të jenë “nën kontroll” për t’u siguruar që sistemi të ofrojë AAP të cilësisë së mirë.

2.2 Informatat e përgjithshme mbi sigurimin e cilësisë në nivel sistemi të AAP-së

AKK luan rol të rëndësishëm në cilësi dhe qasjet e sigurimit të cilësisë në sistemin e AAP-së në vend. Komponentet e tjera të rëndësishme të sistemit të cilësisë përfshijnë:

- vlerësimin e jashtëm të shkollave profesionale përmes inspektimeve administrative dhe profesionale nga Departamenti i Inspektimit të MASH-it;
- sigurimin e cilësisë së Qendrave të MPMS-ës për Aftësim Profesional dhe qendrave mobile nga APRK;
- vlerësimin e brendshëm të shkollave nëpërmjet praktikës më të re, atë të vetëvlerësimit;
- rolin e sigurimit të cilësisë së Zyrës për Standarde dhe Vlerësim në MASH;
- rolin e komunave, i cili në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe menaxhimi i fondeve të shkollës, stafit dhe infrastrukturës, me përjashtim të 6 Qendrave të Kompetencës, të cilat menaxhohen nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr);
- përfshirjen e partnerëve social dhe palëve të interesuara nëpërmjet KAAPARr-së për zhvillimin e standardeve të profesionit.

2.3 Sigurimi i cilësisë në lidhje me fushat kyçe të AAP-së

Evidenca – statistikat dhe kërkim-zhvillimi

Kërkesa për aftësim identifikohet përmes hulumtimeve të sponsorizuara nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, shoqatat e biznesit dhe projektet e financuara nga donatorët. Megjithatë, hulumtimi kryhet në bazë ad-hoc dhe është i kufizuar në fushëveprimin e vet.

Në vitet e fundit, janë kryer analiza të nevojave të tregut të punës për shkathtësitë që duhet të verifikohen për një shumëllojshmëri sektorësh duke përfshirë TIK-un, nënsektorët kryesorë të agrobiznesit, sektorin e ndërtimit, prodhuesit tradicionalë të ëmbëlsirave, përpunimin e drurit, inxhinierinë mekanike etj. Donatorët që realizojnë këto analiza i përdorin ato për t'u informuar në ofrimin e kualifikimeve, kurrikulës dhe trajnimit (kryesisht të tyre).

Megjithatë, nuk ka prova se rezultatet e studimeve të realizuara nga donatorët kanë qenë të dobishme në përshtatjen e ofrimeve të programit të AAP-së. Këto vendime shpesh janë marrë në bazë të kushteve mbizotëruese në shkolla dhe mësuesit e lëndëve që janë të disponueshëm. Shkollat e AAP-së dhe bordet drejtuese të tyre, si rregull nuk mund të vendosin lirshëm rreth kurseve që ofrojnë.

Implementimi i sistemit të informacionit të menaxhimit (MIS) të AAP-së filloi në vitin 2012. Grumbullohen të dhënat e përshtatshme me disa tregues të Kornizës Evropiane Referuese për Sigurimin e Cilësisë (3, 4, 7 dhe 8a). Për shembull, grumbullohen dhe publikohen të dhëna të gjera mbi pjesëmarrjen në arsimin e mesëm të AAP-së (publik dhe privat), të ndara sipas gjinisë, moshës, etnisë, klasës, rezultateve arsimore dhe niveleve të ndërprerjes së shkollimit. Gjithashtu, mësuesit monitorohen sipas gjinisë, moshës, vendndodhjes dhe kualifikimeve. Është përcaktuar një databazë e re për të lehtësuar licencimin e mësuesve. Ç'është e rëndësishme në terma të sigurimit të cilësisë, MIS-it i mungon kapaciteti për të gjurmuar rrugët e destinacioneve/karrierës të të diplomuarave të AAP-së.

Sigurimi i cilësisë dhe cikli i kualifikimeve

AKK-ja është përgjegjëse për të siguruar që proceset për sigurimin e cilësisë, ekzistojnë, me qëllim të ruajtjes së cilësisë së kualifikimeve të regjistruara në KKK dhe që u jepen nxënësve/kandidatëve nëpërmjet:

- sigurimit të cilësisë gjatë ofrimit, vlerësimit dhe dhënies së kualifikimeve të vlefshme dhe të miratuara brenda kornizës;
- sigurimit të cilësisë nga institucionet e akredituara për dhënien e tyre; dhe
- verifikimit të standardeve të profesionit.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është i themeluar me ligj dhe ka Këshillin Drejtues me 13 anëtarë që përfaqësojnë ministri qeveritare, organizata, partnerë socialë dhe universitete të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e politikave në nivel të KKK.

Deri më sot, AKK-ja ka validuar në KKK 88 kualifikime, si dhe ka akredituar më shumë se 60 ofrues të AAP. AKK ka verifikuar deri më tani 116 standarde të profesionit, të cilat shërbejnë si urëlidhëse mes kërkesave të tregut të punës dhe kualifikimeve. Në vitin 2020, janë në proces të verifikimit edhe 19 standarde të profesionit.

Uebporti i AKK-së ka një regjistër kombëtar standardesh të aprovuara dhe të pa aprovuara, si dhe informatat lidhur me institucionet e akredituara dhe kualifikime të validuara në KKK.

AKK-ja ka zhvilluar procesin e ndërlidhjes së KKK të Kosovës me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) në vitin 2016. Po ashtu së fundmi, pra në vitin 2020, AKK ka paraqitur "Raportin e njëfishtë" mbi zhvillimet e shtetit të Kosovës rreth validimit të mësimin joformal dhe informal dhe implementimin e kësaj komponente para Grupit Këshillëdhënës së KEK.

Sigurimi i cilësisë dhe institucionet e ofrimit/ofruese të AAP-së

Detyrimi ligjor për shkollat e AAP-së është organizimi i procesit të vetëvlerësimit dhe publikimi i raporteve vjetore të vetëvlerësimit, si një hap i rëndësishëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të cilësisë në AAP. Po ashtu, udhëzimi administrativ nga MASH-i i lëshuar në vitin 2014 përcakton se institucionet e AAP duhet të kenë zyra të sigurimit të cilësisë që kryejnë detyrat e mëposhtme: të sigurojnë mbarëvajtjen vjetore dhe periodiket të monitorimit; të ofrojnë këshilla për udhëheqësit e lëndës dhe të tjerët për përgjegjësit e tyre lidhur me sigurimin e cilësisë; të koordinoj mbledhjen e informatave nga palët e interesit, veçanërisht nxënësit; të koordinoj funksionin e një skeme të vëzhgimit/mentorimit të mësimdhënies; të koordinoj përgatitjet e dokumenteve për vlerësimin e institucionit.

Shumica e shkollave profesionale në Kosovë kanë koordinatore të cilësisë, por pothuajse nuk ka asnjë komunikim apo shkëmbim informacioni mes MASH-it, DKA dhe koordinatoreve të cilësisë.

Në anën tjetër, kualifikimet në përgjithësi zhvillohen nga zhvilluesit, të cilët në këtë rast janë MASH, MPMS-ja, ofruesit e AAP, shoqatat e biznesit etj, gjithmonë në bashkëpunim me partnerët socialë.

Kualifikimet e zhvilluara për tu përfshirë në KKK, duhet të dorëzohen në AKK për t'iu nënshtruar procesit të validimit dhe aprovimit. Kualifikimet e AAP-së vendosen në KKK nëpërmjet një mekanizmi të zhvilluar dhe menaxhuar nga AKK-ja. Ai përbëhet nga procedurat për validimin dhe miratimin e kualifikimeve për përfshirje në nivelet e përcaktuara të kornizës dhe kriterëve, si dhe proceseve për akreditimin e ofruesve që ofrojnë këto kualifikime.

Procesi i validimit, i cili është i përcaktuar në ligj, është transparent dhe përbëhet nga katër faza: në fazën e parë, institucioni i cili kërkon validimin e një kualifikimi/moduli bën një kërkesë, e cila qartë paraqet arsyetimin për kualifikimin/modulin; në fazën e dytë, një panel i emëruar i ekspertëve i mbështetur nga AKK-ja e vlerëson kërkesën; në fazën e tretë raporti dhe rekomandimet e ekspertëve i paraqiten Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimin përfundimtar; dhe në fazën e katërt, kualifikimi/moduli i miratuar vendoset në KKK dhe publikohet. Po ashtu, sipas legjislacionit në fuqi, ofruesit të cilët dëshirojnë të ofrojnë kualifikime të validuara në KKK duhet të përfshihen në procesin e akreditimit.

Procesi i akreditimit gjithashtu ka katër faza ku fillimisht institucioni aplikues dorëzon një aplikim të plotë, duke përfshirë aplikacionin për validim dhe akreditim, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionet tjera shtesë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Pastaj ekipi i ekspertëve vlerëson aplikacionin, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionet tjera shtesë të ofruara nga institucioni aplikues, viziton institucionin aplikues, harton draft raportin dhe bën rekomandime, paraqet draft raportin të AKK. Si fazë e tretë, institucionit aplikues i dërgohet një draft-raport vlerësimi për komente. Më pas raporti përfundimtar i dërgohet Këshillit Drejtues të AKK-së i cili merr vendime për akreditim me vendim të shumicës. Si dhe faza e fundit, AKK publikon vendimin final dhe lëshon dokumentacionin e nevojshëm duke konfirmuar statusin e institucionit.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, implementimin e KKK dhe krijimin e sistemit të kualifikimeve, të gjitha kualifikimet duhet t'i nënshtrohen procesit të validimit si dhe të gjithë ofruesit e AAP-së duhet të përfshihen në procesin e akreditimit. Por, në realitet kualifikimet e zhvilluara nga autoritetet publike dhe shkollat publike të AAP-së u pa mundësohet aplikimi për të hyrë në këtë proces. Arsyeja për këtë është se një numër i konsiderueshëm kualifikimesh të ofruara nga shkollat publike nuk i plotësojnë kriteret e vlerësimit dhe shumë nga to nuk i plotësojnë kriteret e akreditimit. Po ashtu, sfida e këtij procesi mbetet zhvillimi i standardeve të profesionit, për profilet që ofrohen nga shkollat publike të AAP.

Sigurimi i cilësisë dhe standardet e kualifikimeve për zhvillim profesional të vazhdueshëm për mësuesit/trajnerët e AAP-së

Stafi pedagogjik në shkollat sekondare profesionale të Kosovës përfshijnë si mësime të mësimdhënës po ashtu edhe instruktorë. Aty ku mësime të mësimdhënës është përgjegjës për pjesët teorike dhe praktike të një moduli ose lënde të caktuar, instruktori ofron asistencë vetëm me trajnimin praktik. Kështu, roli i instruktorit nuk është qartësuar mjaftueshëm në legjislacionin sekondar.

Me disa përjashtime, MASH-i kërkon që mësuesit e AAP-së të sapo punësuar të kenë gradën Master. Ndryshe nga kjo, instruktorëve u kërkohej të kenë kualifikim post-sekondar dhe të kenë të paktën pesë vjet përvojë në fushat e tyre përkatëse.

Përgjegjësia për rekrutimin e mësime të mësimdhënësve u takon drejtorive arsimore të komunave, përveç gjashtë shkollave që veprojnë nën ombrellën e AAAPRr. MASH-i ofron një procedurë të përgjithshme për emërimin e mësime të mësimdhënësve të rinj. Komunitat janë të lira të përcaktojnë kriteret e tyre specifike për procesin e rekrutimit.

Si rregull, mësime të mësimdhënësve në Kosovë u kërkohej të plotësojnë kualifikimet e tyre universitare pa shpërburje nga puna, por ka kapacitete të pamjaftueshme për ofrimin e trajnimit pa shpërburje nga puna për shkak të numrit të kufizuar të ofruesve të trajnimit dhe burimeve të pakta. Kjo situatë reflektohet gjithashtu në shkollat profesionale ku, përveç pjesës teorike të programit, mësime të mësimdhënësve u kërkohej gjithashtu t'u japin trajnim praktik nxënësve të tyre. Një numër i konsiderueshëm mësime të mësimdhënësve nuk kanë përvojë paraprake për punën praktike.

Konstatimet e një studimi të sponsorizuar nga ETF tregojnë se dhënia e trajnimit të mësime pa shpërburje nga puna nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat nga procesi i licencimit për mësime të mësimdhënësve të AAP-së, që kërkon 100 orë kontakti gjatë pesë viteve. Studimi gjithashtu arriti në përfundimin se projektimi i trajnimit pa shpërburje nga puna nuk është përshtatur për të plotësuar nevojat aktuale të mësime të mësimdhënësve, dhe shkollat nuk janë në gjendje të planifikojnë trajnim në mënyrë të tillë që kontribuon në prioritetet e tyre.

3. PËRPARËSITË, ZHVILLIMET DHE NEVOJAT

3.1 Nevojat dhe sfidat

Sfidat në lidhje me përmirësimin e sigurimit të cilësisë në AAP përfshijnë nevojën që:

- të forcohen lidhjet mes AAP-së dhe tregut të punës, duke përfshirë analizën e nevojave për aftësi në tregun e punës në një sistem të informacionit të menaxhimit të punës dhe shtimin e një moduli për gjurmimin e të diplomuarve në sistemin e informacionit të menaxhimit;
- të vazhdohet me zhvillimin e masave që lidhen me AKK-në, duke përfshirë mekanizmat e sigurimit të cilësisë si edhe standardet e AAP-së, kurrikulën dhe materialet mësimore;
- të aplikohet një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin profesional të mësuesve dhe trajnuesve dhe mbështetjen e vlerësimit të performancës së të gjithë mësuesve;
- të vazhdohet zhvillimi dhe implementimi i kuadrit të sigurimit të cilësisë për AAP-në;
- të shqyrtohet dhe të përmirësohet vlerësimi përmbledhës i kryer nga MASH-i përmes provimit të maturës shtetërore;
- të implementohet plotësisht Vendimi i MASH-it i vitit 2016 për të akredituar shkollat publike;

- të adresohen burimet e pamjaftueshme njerëzore të inspektoratit të MASH-it (në vitin 2018, ligji për inspektoratin u pezullua, në pritje të miratimit nga qeveria);
- të adresohen burimet e pamjaftueshme njerëzore për volumnin e punës të caktuar për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

4. SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA

Qendrat e Kompetencës (QeK) në Ferizaj dhe Prizren, duke marrë mbështetje nga Lux-Development dhe MASH-i janë bërë shembuj lider të institucioneve moderne të AAP-së. Për profilet e tyre arsimore, QeK në Ferizaj dhe Prizren kanë zhvilluar një numër standardesh të profesionit me kurrikulën modulare, materialet mësimore, infrastrukturën e nevojshme dhe punëtorët të pajisura me mjetet specifike për organizimin e duhur të praktikës profesionale.

Në përgjithësi, QeK-ët kanë kryer një proces për të harmonizuar standardet e profesionit dhe kurrikulën ekzistuese. Disa profile kanë standarde të profesionit, por ende kanë nevojë për shqyrtimin e kurrikulës dhe zhvillimin e materialeve mësimore.

QeK janë partneritete pioniere publike-private me ambiente moderne, ndërkohë që i përgjigjen një kërkesë të lartë për profile mësimore. Për shembull, QeK Ferizaj ofron nëntë profile në sektorët shëndetësorë dhe QeK Prizren ofron shtatë profile në ekonomi, tregti dhe turizëm.

Gjithashtu, QeK në Prizren, në vazhdim e sipër punon për ndërtimin e kapaciteteve dhe të përshtasë kurrikulën dhe materialet e veta mësimore për t'u bërë një qendër e aprovuar nga Pearson dhe t'u japë nxënësve mundësinë që të fitojnë kualifikime BTEC të njohura në nivel ndërkombëtar. QeK Ferizaj ka nisur një partneritet afatgjatë me Heimerer Academy (Gjermani) për të shqyrtuar kurrikulën e vet dhe materialet mësimore. QeK Ferizaj dhe QeK Prizren ka dy, respektivisht gjashtë kualifikime të validuara nga AKK-ja dhe janë akredituar për t'i ofruar këto kualifikime.

Zhvillimet e fundit në Sigurimin e Cilësisë të AAP

Në vitin 2019 është aprovuar udhëzimi administrativ për kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë NJMP në Kosovë. Me qëllim të zbatimit të NjMP AKK ka zhvilluar aktivitete të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për implementimin e NjMP dhe ngritjes së kapaciteteve për implementimin e NjMP siç janë trajnimet e ekipeve vlerësuese që do të bëjnë vlerësimin e ofruesve që ofrojnë kualifikime nëpërmjet NjMP dhe trajnimet për stafin e ofruesve që zbatojnë NjMP pra praktikuesit siç janë: koordinatori, mentori dhe vlerësuesit (të brendshëm dhe të jashtëm). Në këtë fazë është duke u zhvilluar procesi i akreditimit për ofruesit e parë që kanë aplikuar për procesin e akreditimit të NjMP.

Zhvillimi i komponentës së Njohjes së Mësimi Paraprak në Kosovë është mbështetur nga ETF.

Vlen të theksohet se bazuar në situatën e krijuar nga pandemia Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) me vendimin e KD ka nxjerrë qarkoren për procedurat lidhur me zhvillimin e takimeve virtuale dhe të përshtatura gjatë proceseve të validimit të kualifikimit/modulit dhe akreditimit institucional, akreditimit për ofrimin e Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP), si dhe procesit të verifikimit të standardit të profesionit.

Po ashtu AKK ka filluar procesin e monitorimit për institucionet e akredituara nga distanca nëpërmjet mbledhjes së informatave relevante rreth mësimeve/trajnereve të angazhuar, numrit të kandidatëve, vlerësimin dhe certifikimin, kredite, etj.

Hulumtim dhe pasqyrim i mekanizmave për sigurimin e cilësisë, përfshirë akteret relevant dhe ofruesit. Ky proces është mbështetur nga projekti i financuar nga BE. Kjo ka për qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale në nivel vendi. Në kuadër të këtij aktiviteti janë përfshirë 20 shkolla të AAP me qëllim të ngritjes së kapaciteteve si dhe implementimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Së fundmi është bërë publikimi i platformës së “Barometrit të tregut të punës” në bashkëpunim me MPMS, Agjencinë e Statistikave, MASH dhe partnerët relevant me qëllim të identifikimit të nevojave e tregut të punës në nivel vendi. Ky instrument përmban statistikat nacionale, të punësimit, të arsimit dhe të punëdhënësve.

Është aprovuar udhëzimi administrativ për të Mësuarit në Vendin e Punës (MVP) në Institucionet e AAP, udhëzim i cili ka për qëllim që të bëjë rregullimin, mënyrën e organizimit, zbatimit si dhe të vlerësimit në vendin e punës (MVP) për nxënësit/kandidatët e IAAP.

Ku të zbuloni më shumë

Faqja e internetit
www.etf.europa.eu

ETF Open Space
<https://openspace.etf.europa.eu>

Twitter
[@etfeuropa](https://twitter.com/etfeuropa)

Facebook
facebook.com/etfeuropa

YouTube
www.youtube.com/user/etfeuropa

Instagram
instagram.com/etfeuropa/

LinkedIn
linkedin.com/company/european-training-foundation

E-mail
info@etf.europa.eu